



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2024:099288

Datë: 02.04.2024

Numri i dokumentit: 05531957

P.nr.133/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, duke vendosur në lëndën penale kundër të pandehurit G. G. nga J., për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par.1 të KPRK-së, të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.1098/2024, të datës 19.03.2024, duke vendosur lidhur me kërkesën e prokurorisë për dhënien e urdhrin ndëshkimor, jashtë seancës gjyqësore, me datën 02.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-së në Prishtinë, PP.II.nr.1098/2024, të datës 19.03.2024, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Kundër të pandehurit:

G. G., i lindur me datë ..., në "J.", ku edhe jeton, nga i ati A., e ëma H., me mbiemër të vajzërisë B., me numër personal ..., i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer katër vjet të shkollës fillore, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i padënuar, mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R Ë

Sepse:

Me date 09.02.2024, rreth orës 14:20, në fshatin J., Komuna e L., i pandehuri G. G. me dashje e ka kanosur seriozisht me fjalë të dëmtuarin M. K., në atë mënyrë pasi i dëmtuari iu kishte drejtuar të pandehurit me fjalët: "O G.qat gardh shumë e ke prish, a pak po duket që e ke shty megjen, a mos po don krejt po ta jepi (lshoje)", i pandehuri iu ka drejtuar të dëmtuarit me fjalët kërcënuese: "met pa te gardhi, qaty të la", atëherë i dëmtuari iu ka drejtuar me fjalët: "Se kurrë nuk do ta lë këtë gardh këtu, atëherë i pandehuri prap iu ka drejtuar me fjalët kërcënuese duke i thënë:" Në rregull pra, ja unë ja ti aty, me ç' rast tek i dëmtuari M. K., ka shkaktuar ndjenjën e ankthit, frikës dhe pasigurisë për jetën e tij,-

- Me këtë ka kryer veprën penale, Kanosja nga neni 181 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, në konform dispozitave të neneve, 1, 2, 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 dhe nenit 181 par.1 të KPRK-së, si dhe neneve 493, 495 si dhe nenit 364 të KPPK-së, të pandehurin e gjykon me:

DËNIM ME GJOBË

Të pandehurit i shqipton dënim me gjobë në shumë prej **200.-€**, (dyqindeuro), të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguaj, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se dënimi nuk realizohet as me detyrim, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë me dënim me burgim, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg, të llogaritet shuma prej 20-€.

I dëmtuari: M. K. nga J., udhëzohet që kërkesën pasurore-juridike ta realizojë në procedurë të rregullt civile.

DETYROHET i pandehuri në emër të paushallit gjyqësor, kësaj gjykate t'ia paguaj shumën prej 20-€, për Fondin e Mbrojtjes së Viktimave të Krimit, shumën prej 20-€, këto në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj PP.II.nr.1098/2024, të datës 19.03.2024 e ka akuzuar të pandehurin G. G. nga J., për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par.1 të KPRK-së, si dhe në të njëjtën datë ka kërkuar që të pandehurit ti shqiptohet urdhër ndëshkimor-dënim me gjobë për veprën e lartcekur penale.

Gjykata duke analizuar aktakuzën, si dhe kallëzimin penal me numër të rastit ... i dates 15.02.2024, Raporti i policit hetues i dt.09.02.2024, Raporti fillestar i incidentit dt.12.02.2024, procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtarin i datës 09.02.2024, procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin i datës 09.02.2024, Certifikata pronësore e dt.09.02.2024 si dhe fotot e vendit të ngjarjes, gjykata konstaton se ka prova të mjaftueshme në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtetë ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me dispozitën e nenit 493 të KPPK-së parashihet se “Për vepra penale e cila parashihet dënimi me gjobë ose burgim deri në 3 (tre) vite, për të cilat prokurori i shtetit është i informuar me provat e besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkojë në aktakuzë që gjykata të jep urdhër ndëshkimor, në të cilin të akuzuarit do ti shqiptoi dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor”.

Gjyqtari me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes konform nenit 493 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për shqyrtimin e urdhrit ndëshkimor ndaj të pandehurit nga arsyet se dënimi për veprën penale me të cilën ngarkohet i pandehuri parashihet dënim me gjobë apo me burgim deri në 3 (tri) vite andaj gjykata konform dispozitave të lartcekura vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor u bazua konform nenit 449 dhe neni 450 të KPPK-së ndërsa vendimi për kompenzimin e viktimave të krimit u mor në bazë të nenit 36 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore- juridike, u bazua konform nenit 462 të KPPK-së, pasi që nuk ka prova në shkresat e lëndës të cilat e vërtetojnë lartësinë e dëmit të shkaktuar, andaj nga këto arsye i dëmtuari u udhëzua që kërkesën pasurore-juridike ta realizoj në procedurë të rregullt.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN
P.nr.133/24, me datën 02.04.2024

G J Y Q T A R I
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë në kundërshtim në afat prej 8 (tetë) dite nga dita e marrjes së të njëjtit, kundërshtimi i drejtohet gjyqtarit individual të kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2024:099288
Datë: 02.04.2024
Numri i dokumentit: 05531957